

RRITJA E LLOGARIDHËNIES DHE TRANSPARENCËS BUXHETORE NË PLANET VENDORE TË VEPRIMIT PËR ENERGJINË DHE KLIMËN

RAPORT

SHKURT 2025



Funded by
the European Union



Budget
Accountability
and Transparency



Ky raport është hartuar nga Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri (INLSH) si pjesë e projektit "Rritja e Llogaridhënies dhe Transparencës Buxhetore në Planet Vendore të Veprimit për Energjinë dhe Klimën" (BAT).

Projekti "BAT Civil Society - Kapacitete për Mbikëqyrje Civile të Llogaridhënies dhe Transparencës Buxhetore" zbatohet nga IDM Albania, CRPM, Faktoje, dhe financohet nga Bashkimi Europian. Qëllimi është fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për të promovuar transparencën dhe pjesëmarrjen në proceset buxhetore dhe politikat për energjinë dhe klimën.

Përgatitën Raportin (Sipas Rendit Alfabetik):

1. **Eldisa Zhebo**, Drejtore Ekzekutive, Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri
2. **Entela Kaleshi**, Drejtore Programi, Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri
3. **Rabije Zika**, Juriste/Koordinatorë projekti, Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri

Raporti pasqyron analizën e situatës aktuale dhe progresin në proceset buxhetore dhe hartimin e Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK), bazuar në të dhënat dhe përvojat e ndara nga të gjitha palët e përfshira. Ky raport është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës që ka përfshirë mbledhjen e të dhënave nga 61 bashki, organizimin e workshop-eve dhe konsultimeve publike, si dhe zhvillimin e intervistave me përfaqësues lokalë dhe aktorë të tjerë të interesuar. Përgjegjësia për interpretimin dhe analizën e të dhënave i takon ekskluzivisht ekipit të INLSH.

Koordinatorët Vendorë për Bashkitë:

- **Loreta Mamani** – Gjirokastrë, Qendra Multidisiplinare për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim
- **Elena Mullaraj** – Përmet, Progresi
- **Elinda Idrizi** – Aktiviste, Shkodër
- **Entela Maçka** – Gruaja në Zhvillim, Korçë
- **Zoica Bardhi** – New Bridges Association, Berat
- **Ferit Milanji** – Instituti i Kulturës Romë në Shqipëri, Dega Divjakë
- **Brikena Cjapi** – LAG Roskovec, Grupi Vendor i Veprimit

Organizatrat Bashkëpunuese:

- **Qendra për Zhvillim dhe Iniciativa Sociale**, Sarandë, Vlorë
- **Qendra Rinore**, Vlorë
- **Shërbimi Vendor për Organizatën**, Bulqizë
- **Qendra për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal (CDC)**, Sarandë
- **Qendra Youthful**

PERMBAJTJA

1	HYRJE	5
1.1	Konteksti i Përgjithshëm	5
1.2	Kuadri dhe Konteksti i Projektit	5
1.3	Qëllimi dhe Objektivat e Raportit.....	6
2	METODOLOGJIA	6
2.1	Qasjet e Ndjekura	6
2.2	Angazhimi i OSHC-ve dhe Palëve të Interesuara.....	7
2.3	Limitimet e Studimit.....	7
3	KUADRI LIGJOR PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË DHE KLIMËN DHE ROLI I AKTORËVE ...	8
3.1	Përmbledhje e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PIEK).....	8
3.2	Detyrimet e Bashkive për PVVEEK.....	8
3.3	Roli i Aktorëve Institucionalë.....	9
3.4	Roli i OSHC-ve	10
4	GJENDJA AKTUALE E HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË PVVEEK.....	11
4.1	Statusi i Hartimit dhe Zbatimit të PVVEEK nga Bashkitë.....	11
4.2	Praktikat Aktuale të Transparencës dhe Gjithëpërfshirjes.....	13
4.2.1	Shqyrtimi i publikimit online të informacionit	14
4.2.2	Konsultimet Publike me 7 Bashki në fokus	14
4.2.3	Workshope në Shtatë Bashki për Pjesëmarrjen Qytetare	14
4.2.4	Intervista me Bashkitë.....	16
5	GJETJET KRYESORE	17
5.1	Sfida Kryesore në Hartimin dhe Zbatimin e PVVEEK dhe Procesit Buxhetor	17
5.2	Praktikat Pozitive dhe Rastet e Suksesit	17
5.3	Roli i OSHC-ve dhe Konsultimeve Publike	18
6	REKOMANDIMET	19
6.1	Për Bashkitë: Masat për Përmirësimin e Transparencës dhe Gjithëpërfshirjes.....	19
6.2	Për OSHC-të: Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Rritja e Ndikimit.....	20
7	ANEKSE	22

SHKURTIME

AEE - Agjencia për Efiçencën e Energjisë

BAT - Buxheti, Përgjegjshmëria dhe Transparenca

BRE - Burime të Rinovueshme të Energjisë

EE - Efiçenca e Energjisë

INLSH - Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri

OSHC - Organizatat e Shoqërisë Civile

PIEK - Plani i Integruar i Energjisë dhe Klimës

PVVEEK - Planet Vendore të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe Klimës

VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave

1 HYRJE

1.1 Konteksti i Përgjithshëm

Në sfondin e përpjekjeve globale për të adresuar ndryshimet klimatike dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, efienca e energjisë zë një rol kyç. Shqipëria, si pjesë e angazhimeve të saj kombëtare dhe ndërkombëtare, ka miratuar Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PIEK) 2021-2030¹, që përcakton objektiva specifike për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe për rritjen e përdorimit efikas të energjisë. Një nga detyrimet kryesore të këtij plani është hartimi dhe zbatimi i Planeve Vendore të Veprimit për Efiençën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK) nga të gjitha bashkitë e vendit, në përputhje me kuadrin ligjor të miratuar.

Këto dokumente përmbajnë një sërë masash dhe objektivash për të rritur përdorimin efikas të energjisë, për të promovuar energjinë e rinovueshme dhe për të reduktuar ndikimet negative në klimë. Zbatimi i këtyre planeve është një proces kompleks që kërkon bashkëpunim të ngushtë midis autoriteteve lokale, sektorëve privatë dhe qytetarëve, duke pasur parasysh gjithashtu mungesën e burimeve të mjaftueshme dhe kapaciteteve teknike.

1.2 Kuadri dhe Konteksti i Projektit

Raporti është realizuar në kuadër të projektit "Llogaridhënies dhe Transparencës Buxhetore" (BAT), i cili ka si objektiv kryesor forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në proceset buxhetore në nivel vendor. Ky projekt është një përpjekje për të përmirësuar menaxhimin dhe shpërndarjen e burimeve publike, duke siguruar që qytetarët dhe palët e interesuara të kenë mundësinë të ndjekin dhe ndikojnë në mënyrën se si shpenzohen fondet e shtetit.

Në kuadër të këtij projekti, janë përfshirë 12 organizata të shoqërisë civile (OSHC) nga shtatë bashki kryesore të vendit, me qëllimin për të rritur kapacitetet e këtyre organizatave për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Planeve Vendore të Veprimit për Efiençën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK). Ky angazhim përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve që kanë për qëllim forcimin e rolit të OSHC-ve në proceset e vendimmarrjes dhe implementimit të politikave të energjisë dhe klimës.

Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit përfshijnë trajnime, workshope dhe konsultime publike, të cilat kanë mundësuar krijimin e një hapësire për diskutime dhe shkëmbim mendimesh mes aktorëve të ndryshëm të interesuar. Këto aktivitete kanë luajtur një rol të rëndësishëm në identifikimin e sfidave dhe mundësive për përmirësimin e proceseve buxhetore dhe në forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore, OSHC-ve dhe qytetarëve.

Përmes këtyre aktiviteteve, projekti ka kontribuar në përforcimin e rolit të organizatave të shoqërisë civile si aktorë të rëndësishëm të ndryshimit në nivel lokal dhe në nivel kombëtar. Ato kanë mundësuar një angazhim më të thellë të qytetarëve dhe kanë ndihmuar në krijimin e një kulture më të fortë të transparencës dhe llogaridhënies, duke siguruar që politika dhe buxhetimi i

¹ <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Plani-kombetar-per-Energjiine-dhe-Klimen.pdf>

energjisë dhe klimës të jetë më i hapur dhe i përgjegjshëm ndaj nevojave dhe kërkesave të komunitetit.

1.3 Qëllimi dhe Objektivat e Raportit

Ky raport ka si synim të ofrojë një vlerësim të situatës aktuale në lidhje me hartimin dhe zbatimin e Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK) nga bashkitë e Shqipërisë. Ai ka disa qëllime kryesore, të cilat do të analizohen për të ofruar një pasqyrë të qartë mbi sfidat dhe mundësitë e përmirësimit të procesit të implementimit të këtyre planeve. Synimet kryesore janë:

- Të analizojë situatën aktuale të hartimit dhe zbatimit të PVVEEK nga bashkitë.
- Të vlerësojë shkallën e transparencës dhe përfshirjes në proceset buxhetore të lidhura me energjinë dhe klimën.
- Të identifikojë rolin dhe potencialin e OSHC-ve për të ndikuar pozitivisht në këto procese.

Përmes kësaj analize, raporti synon të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e procesit të hartimit dhe zbatimit të PVVEEK, duke forcuar njëkohësisht transparencën, llogaridhënien dhe përfaqësimin e qytetarëve në këto politika.

2 METODOLOGJIA

2.1 Qasjet e Ndjekura

Raporti është bazuar në një qasje të kombinuar cilësore dhe sasiore, duke përdorur metoda që mbledhin të dhëna nga dokumentet zyrtare, intervistat me aktorë kryesorë dhe pjesëmarrësit në terren, si dhe proceset e konsultimit publik. Këto qasje kanë për qëllim të sigurojnë një analizë të gjithëanshme dhe të thelluar mbi proceset e buxhetimit transparent dhe me pjesëmarrje. Hapat kryesorë përmbajnë:

Analizë e Dokumentave : Shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politikëbërës në nivel kombëtar dhe vendor, duke përfshirë dokumentet kryesore si:

- Vendimi Nr. 480, datë 31.7.2018, për Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030.
- Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore."
- Ligji Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit."
- Ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik."
- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Neni 16 mbi detyrimet për konsultimin publik.
- Ligji Nr. 28/2021 "Për Eficiencën e Energjisë" dhe Neni 9/1 mbi detyrimet e bashkive për planet vendore të veprimit.

Mbledhja e të Dhënave Primare: Kryerja e intervistave gjysëm-strukturuara me përfaqësues të bashkive, OSHC-ve dhe Agjencisë Kombëtare për Eficiencën e Energjisë. Intervistat u fokusuan në sfidat dhe mundësitë për buxhetimin transparent dhe me pjesëmarrje.

Konsultime Publike dhe Workshope: Organizimi i workshopeve dhe forumeve në shtatë bashki kryesore (Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Berat, Roskovec, Divjakë dhe Përmet), për të mbledhur mendimet dhe rekomandimet e qytetarëve dhe OSHC-ve mbi proceset buxhetore dhe për përfshirjen e tyre.

Informacion nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë: Janë mbledhur informacione nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, e cila ofron udhëzime dhe mbështetje për politikën dhe projektet që lidhen me energjinë dhe përfshirjen e qytetarëve.

2.2 Angazhimi i OSHC-ve dhe Palëve të Interesuara

Një komponent qendror i metodologjisë ka qenë angazhimi i **organizata të shoqërisë civile (OSHC)** si aktorë kyç në nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor. Ky angazhim ka pasur një rëndësi të veçantë në përpjekjet për të siguruar që proceset e menaxhimit të burimeve publike dhe zbatimit të planeve për energjinë dhe klimën të jenë të hapura, të ndershme dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve. Për këtë qëllim, janë zhvilluar disa aktivitete dhe masa konkrete që i kanë mundësuar OSHC-ve të luajnë një rol aktiv dhe të ndikojnë në përmirësimin e këtyre proceseve. Për këtë qëllim:

- **Trajnimet:** Janë organizuar trajnime specifike për të paktën 12 OSHC, të fokusuar në monitorimin publik të planeve vendore për energjinë dhe klimën.
- **Rrjetëzimi dhe Koordinimi:** OSHC-të kanë lehtësuar procesin e ndarjes së informacionit midis bashkive dhe komunitetit, duke luajtur një rol thelbësor në organizimin e konsultimeve publike dhe mbledhjen e të dhënave.
- **Përfshirja e Aktorëve Vendor:** Konsultimet publike kanë angazhuar qytetarë dhe grupe interesi duke siguruar pjesëmarrje aktive në proceset vendimmarrëse. Përmes këtyre aktiviteteve, është rritur ndërgjegjësimi për nevojën e buxhetimit transparent dhe të përfshirës.

2.3 Limitimet e Studimit

Në zbatimin e metodologjisë së përzgjedhur, janë evidentuar disa kufizime që kanë ndikuar në rezultatet e raportit:

- **Mungesa e të dhënave të plotë:** Jo të gjitha bashkitë kanë dhënë përgjigje ndaj kërkesave për informacion, duke kufizuar mundësinë për të analizuar gjendjen e plotë të proceseve të buxhetimit transparent dhe me pjesëmarrje.
- **Kapacitetet dhe burimet:** Mungesa e OSHC-ve dhe burimeve në disa bashki ka ndikuar në qasjen ndaj proceseve konsultative dhe monitoruese. Në disa raste, pjesëmarrja e qytetarëve dhe sektorit privat në proceset e konsultimit publik ka qenë e kufizuar për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit ose burimeve.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, metodologjia e përzgjedhur ka mundësuar mbledhjen e të dhënave të vlefshme dhe të besueshme, që pasqyrojnë situatën aktuale mbi buxhetimin transparent dhe me pjesëmarrje.

3 KUADRI LIGJOR PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË DHE KLIMËN DHE ROLI I AKTORËVE

3.1 Përmbledhje e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PIEK)

Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PIEK) për vitet 2021-2030 është një dokument strategjik kyç që përcakton politikat dhe masat kryesore të Shqipërisë për të arritur objektivat e saj për dekarbonizim, rritjen e efikasitetit energjetik, dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Ky plan është i orientuar në përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare, përfshirë Marrëveshjen e Parisit dhe objektivat e Bashkimit Evropian për klimën dhe energjinë, dhe ka si qëllim të kontribuojë në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë energjetike të vendit.²

Sipas PIEK, Shqipëria ka vendosur të reduktojë ndjeshëm emetimet e gazeve serrë dhe të përmirësojë efikasitetin energjetik në të gjitha sektorët e ekonomisë. Për realizimin e këtyre objektivave, plani identifikon pesë dimensionë strategjike, të cilat janë bazuar në prioritetë kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm dhe luftimin e ndryshimeve klimatike:

PIEK përcakton pesë dimensionë strategjike:

1. Dekarbonizimi përmes uljes së emetimeve të gazeve serrë.
2. Rritja e burimeve të rinovueshme të energjisë.
3. Përmirësimi i efikasitetit energjetik në sektorët kryesorë.
4. Siguria energjetike.
5. Promovimi i kërkimit dhe inovacionit në energjinë e gjelbër.

Sipas PIEK dhe **VKM Nr. 827, datë 29.12.2021**, bashkitë janë **aktorët kyç** për **zbatimin lokal** të politikave të energjisë dhe klimës, duke hartuar **Plane Vendore të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK)**. Këto plane duhet të jenë në përputhje me standardet dhe objektivat kombëtare të përcaktuara nga PIEK dhe të sigurojnë që masat dhe politikat e energjisë të implementohen në nivelin më të ulët të administratës, për të pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe për të kontribuar në realizimin e qëllimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për klimën dhe energjinë.

3.2 Detyrimet e Bashkive për PVVEEK

Ligji Nr. 28/2021 “Për Efiçencën e Energjisë” dhe Ligji Nr. 124/2015 përcaktojnë detyrimet e bashkive për hartimin dhe zbatimin e **Planeve Vendore të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK)**, të cilat janë thelbësore për arritjen e objektivave kombëtare dhe

² Marrëveshja e Parisit për Klimën u miratua nga 196 palë në Konferencën e Palëve 2021 që u mbajt në Paris më 12 dhjetor 2015. Marrëveshja hyri në fuqi më 4 nëntor 2016 dhe i detyron ligjërisht palët për zbatimin e saj.

<https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Ligji-75-2016-konventa-okb-klima.pdf>

ndërkombëtare të Shqipërisë për energjinë dhe klimën. Këto detyrime përfshijnë disa masa dhe aktivitete kyçe që duhet të ndjekin bashkitë, të cilat janë të rëndësishme për përmirësimin e menaxhimit të energjisë dhe të uljes së ndikimit negativ të ndryshimeve klimatike në nivel lokal.

Për hartimin e PVVEEK, çdo bashki është e detyruar të krijojë dhe miratojë një plan të tillë, duke u bazuar në të dhëna të sakta mbi konsumin e energjisë në nivel vendor. Ky plan duhet të përfshijë masa specifike për përmirësimin e efikasitetit energjetik, si rinovimi i ndërtesave publike, modernizimi i ndriçimit rrugor dhe promovimi i transportit të gjelbër. Këto masa janë të rëndësishme për arritjen e një menaxhimi më efikas të energjisë dhe për reduktimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Një tjetër detyrim është monitorimi dhe raportimi i zbatimit të PVVEEK. Menaxherët e energjisë të emëruar janë të detyruar të monitorojnë implementimin e planeve dhe të raportojnë arritjet tek Agjencia Kombëtare për Eficiencën e Energjisë (AKEE), duke ndjekur objektivat e kursimit të energjisë.³ Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar që masat e miratuara të zbatohen siç është planifikuar dhe të kontribuojnë në uljen e konsumit të energjisë në nivel lokal.

Pjesëmarrja dhe transparenca publike janë gjithashtu detyrime kyçe për bashkitë. Ata janë të detyruar të publikojnë projekt-planet në regjistrin elektronik dhe të organizojnë konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit, sipas Nenit 6 të Ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Këshillat Bashkiakë duhet të miratojnë PVVEEK pas shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Ky proces siguron transparencë dhe përfshirje të qytetarëve në vendimmarrje. Për më tepër, PVVEEK duhet të jenë të përputhshme me Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe me Politikën Integruese të Energjinë dhe Klimën (PIEK), duke integruar politikën kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që politikën lokale të bashkive të jenë në përputhje me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare të Shqipërisë për energjinë dhe klimën.

Këto detyrime kanë si qëllim të sigurojnë që bashkitë të jenë pjesëmarrëse aktive në procesin e **tranzicionit energjetik**, duke zbatuar politika që kontribuojnë në një zhvillim të qëndrueshëm dhe përmbushin angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për klimën. Në këtë mënyrë, bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në **reduktimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike** dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët.

3.3 Roli i Aktorëve Institucionalë

Aktorët institucionalë kanë një rol të rëndësishëm dhe shumëdimensionale në zbatimin e Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK). Ata luajnë një funksion

³ Sipas Direktivës 2012/27/BE (Direktiva për Eficiencën e Energjisë - EED), qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kategoritë, kushtet dhe kërkesat për kualifikimin dhe njohuritë profesionale të menaxherit të energjisë. Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) pajis menaxherët e energjisë me një certifikatë të testimit të njohurive për të garantuar që ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve që konsumojnë të gjitha format e energjisë, përmirësimin dhe monitorimin e modeleve të përdorimit të energjisë dhe kryerjen e detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në ndërtesa dhe industri.

mbështetës dhe mbikëqyrës për të siguruar që këto plane të zbatohen në përputhje me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare për energjinë dhe klimën. Pjesëmarrja e këtyre aktorëve është jetike për të krijuar një strukturë të qëndrueshme dhe efektive që siguron se masat për efikasitetin energjetik dhe përballimi i ndryshimeve klimatike të realizohen me sukses.

- **Agjencia Kombëtare për Eficiencën e Energjisë (AKEE)** siguron udhëzime teknike dhe monitoron progresin e bashkive në zbatimin e planeve vendore.
- **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** koordinon politikat energjetike kombëtare dhe vendore, duke ofruar financime për projekte prioritare.
- **Këshillat Bashkiakë** miratojnë PVVEEK dhe sigurojnë transparencë dhe përputhshmëri me nevojat e komunitetit.

3.4 Roli i OSHC-ve

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) janë aktorë kyç në promovimin e transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në politikat e energjisë dhe klimës, duke luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e një lidhjeje më të ngushtë mes qytetarëve dhe institucioneve publike. Roli i tyre është shumëdimensional dhe përfshin disa aktivitete thelbësore që mundësojnë një pjesëmarrje më aktive të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe në implementimin e politikave të energjisë dhe klimës. Roli i tyre përfshin:

Advokimi dhe ndërgjegjësimi. OSHC-të nxisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e efikasitetit energjetik dhe luftës kundër ndryshimeve klimatike, përmes fushatave publike dhe trajnimeve. Përmes advokimit, ato promovojnë buxhetimin me pjesëmarrje, duke siguruar që politikat vendore të reflektojnë nevojat e qytetarëve.

Mbikëqyrja e transparencës. OSHC-të monitorojnë procesin e hartimit dhe zbatimit të PVVEEK, duke raportuar për mangësitë dhe ofruar rekomandime për përmirësim. Ato ndihmojnë në zbatimin e kërkesave ligjore për konsultimet publike dhe publikimin e dokumenteve në regjistrin elektronik.

Fuqizimi i qytetarëve. Përmes programeve trajnuese, OSHC-të forcojnë aftësitë e qytetarëve dhe grupeve vendore për t'u përfshirë në vendimmarrje dhe për të kërkuar llogaridhënie nga institucionet publike.

12 OSHC janë trajnuar për të monitoruar PVVEEK dhe për të ndihmuar në organizimin e konsultimeve publike në shtatë bashki të vendit. Këto organizata kanë ndihmuar në rritjen e transparencës dhe në përfshirjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse për energjinë dhe klimën.

Një qasje e integruar dhe e koordinuar ndërmjet bashkive, aktorëve institucionalë dhe OSHC-ve është thelbësore për të siguruar që PVVEEK të jenë të zbatueshme, transparente dhe të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Ky bashkëpunim kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në arritjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare për klimën dhe energjinë.

4 GJENDJA AKTUALE E HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË PVVEEK

4.1 Statusi i Hartimit dhe Zbatimit të PVVEEK nga Bashkitë

Procesi i hartimit dhe zbatimit të Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK) ka qenë një nga sfidat kryesore për autoritetet vendore në Shqipëri. Ky proces ka rezultuar i pabarabartë dhe i kufizuar nga një sërë sfidash strukturore, financiare dhe teknike. Nga një analizë e të dhënave të mbledhura, është e qartë se pjesëmarrja dhe përparimi në hartimin e PVVEEK ndryshon ndjeshëm ndërmjet bashkive.

Nga kërkesat formale për informacion të dërguara nga projekti në të gjitha 61 bashkitë e vendit:

Rreth 50% e bashkive	Vetëm 15% e bashkive (rreth 9 bashki)	Rreth 85% e bashkive
kanë kthyer përgjigje ndaj kërkesave për informacion mbi statusin e PVVEEK.	kanë raportuar se kanë përfunduar PVVEEK dhe kanë nisur zbatimin e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 28/2021 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë. Këto bashki përfshijnë ato më të mëdha, si Korça, Shkodra dhe Berati.	janë ende në faza fillestare ose nuk e kanë nisur procesin, duke raportuar sfida serioze për hartimin e PVVEEK.

Një kërkesë për informacion është dërguar në total për 61 bashki të Shqipërisë, nga të cilat janë marrë përgjigje nga 33 prej tyre. Vlen për t'u theksuar se, pavarësisht se kërkesat janë dërguar më shumë se një herë në adresat zyrtare të bashkive, disa prej tyre nuk kanë kthyer përgjigje, duke shkelur kështu ligjin për të drejtën e informimit.⁴

Në procesin e hartimit të Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën, disa bashki janë angazhuar aktivisht dhe kanë filluar të përgatitin këto plane. Për shembull, bashkitë si **Gjirokastra**, **Patosi**, dhe **Tirana** janë në fazën e hartimit të planeve të tyre vendore. Nga ana tjetër, disa bashki kanë përfunduar dhe miratuar planet e tyre, siç janë bashkitë e **Korçës**, **Përmetit**,

⁴ INLSH ka dërguar kërkesë për informacion në 61 bashkitë e vendit në fund të muajit korrik, bazuar në të drejtën e informacionit, në adresën zyrtare të emailit të bashkisë përkatëse, dhe ordinatorit për të drejtën e informacionit, sipas Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Roskovecit, Berat dhe Shkodrës, duke treguar një përkushtim më të madh në zbatimin e politikave për energjinë dhe klimën.

Ndërkohë, nga përgjigjet që kemi marrë, rezulton se një numër i konsiderueshëm bashkish nuk e kanë hartuar ende Planin e Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën, dhe as nuk janë në proces të hartimit të tij. Këto bashki përfshijnë **Delvinën, Memaliajn, Bulqizën, Pustecin, Devollin, Dibrën, Dimalin, Dropullin, Finiqin, Konispolin, Kuçovën, Kukësin, Kurbinin, Lezhën, Lushnjën, Malësinë e Madhe, Mallakastrën, Matin, Peqin, Pukën, Përrenjas Rrogozhinën, Sarandën, dhe Vlorën**. Këto bashki janë ende në fazën e mungesës së dokumenteve të planifikimit për energjinë dhe klimën, dhe kjo mungesë përkushtimi mund të ndikojë negativisht në arritjen e objektivave kombëtarë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

Bashkitë që kanë treguar progres

Disa nga bashkitë kanë përparuar në këtë proces për shkak të kapaciteteve më të mira teknike dhe financiare, si dhe përfshirjes së mbështetjes nga donatorët ndërkombëtarë:

- **Korça:** Një nga bashkitë më të avancuara në hartimin e PVVEEK, duke përfshirë masa konkrete për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike dhe modernizimin e ndriçimit rrugor.
- **Berati:** Përfshirja e masave për promovimin e energjive të rinovueshme, si panelet diellore, në planin e saj.
- **Shkodra:** Organizimi i konsultimeve publike për PVVEEK dhe zbatimi i masave të hershme për efikasitetin energjetik në infrastrukturën publike.

Sfidat Kryesore

Bashkitë përballen me disa sfida të përbashkëta në procesin e hartimit dhe zbatimit të PVVEEK:



Roli i Menaxherëve të Energjisë

Një nga detyrimet e përcaktuara nga Ligji Nr. 28/2021 është emërimi i menaxherëve të energjisë nga bashkitë për të monitoruar progresin dhe për të ndjekur zbatimin e masave të PVVEEK. Deri më tani:

- Vetëm disa bashki (si Korça, Berati dhe Shkodra) kanë raportuar emërimin e menaxherëve të energjisë.
- Bashkitë që kanë emëruar menaxherë kanë treguar përmirësime në procesin e monitorimit dhe raportimit, duke qenë më të përgatitura për të zbatuar PVVEEK.

4.2 Praktikrat Aktuale të Transparencës dhe Gjithëpërfshirjes

Ligjet ekzistuese, si Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit,” krijojnë një bazë të qartë për promovimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në nivel vendor. Megjithatë, zbatimi praktik i këtyre dispozitave mbetet i kufizuar në shumicën e bashkive.

4.2.1 Shqyrtimi i publikimit online të informacionit

Nga shqyrtimi i informacionit të 61 bashkive, vetëm **15%** kanë përfunduar dhe publikuar PVVEEK në përputhje me detyrimet ligjore, ndërsa **25%** kanë ndarë informacion të pjesshëm ose progres të lidhur me PVVEEK në regjistrin elektronik. Mungesa e transparencës është raportuar si një problematikë kryesore në shumë bashki, si Përmeti dhe Divjaka, ku dokumentet nuk janë bërë të aksesueshme për publikun.

4.2.2 Konsultimet Publike me 7 Bashki në fokus

Nga shtatë bashkitë e përfshira në projekt (Korça, Berati, Shkodra, Gjirokastra, Roskoveci, Divjaka dhe Përmeti), vetëm tri (Korça, Berati dhe Shkodra) kanë organizuar konsultime publike. Pjesëmarrja në këto konsultime ka qenë e kufizuar, dhe në disa raste, si në bashkinë Roskovec, qytetarët dhe grupet e interesit raportuan mungesë njoftimi të mjaftueshëm.

Faktorët Kryesorë të Kufizimit

1. **Ndërgjegjësimi i ulët:** Sipas të dhënave nw Bashkinë Përmet, shumë qytetarë nuk janë të informuar mbi të drejtën e tyre për të marrë pjesë në konsultimet publike, duke ulur pjesëmarrjen.
2. **Mekanizmat joefektivë për përfshirjen:** Shumë bashki nuk kanë krijuar struktura ose mekanizma të qëndrueshëm për të siguruar gjithëpërfshirje. Bashkia Divjakë raportoi se mungesa e burimeve ka ndikuar negativisht në organizimin e konsultimeve gjithëpërfshirëse.
3. **Komunikimi i kufizuar:** Në disa raste, informacionet mbi PVVEEK dhe konsultimet publike janë shpërndarë në mënyrë të pjesshme ose me vonesë, duke reduktuar mundësinë e përfshirjes së qytetarëve.

4.2.3 Workshope në Shtatë Bashki për Pjesëmarrjen Qytetare

Në shtatë bashkitë e vendit, si Bashkia Berat, Roskovec, Divjakë, Gjirokastrë, Korçë, Përmet dhe Shkodër, u zhvilluan workshop-e për buxhetimin dhe pjesëmarrjen qytetare në energjinë dhe klimën. Këto workshop-e kishin për qëllim të informonin qytetarët për të drejtat e tyre për të marrë pjesë në proceset e buxhetimit dhe vendimmarrjes, si dhe për t'i mbajtur ata të informuar dhe të angazhuar për fazat e ardhshme të këtyre proceseve. Takimet e zhvilluara në këto 7 bashki treguan një angazhim të madh nga qytetarët dhe grupet e interesit për të kontribuar në përmirësimin e politikave vendore të energjisë dhe klimës. Pjesëmarrësit kanë theksuar rëndësinë e transparencës, rritjes së mundësive për konsultime të rregullta dhe angazhimin e grupeve të marginalizuara në proceset e vendimmarrjes dhe buxhetimit. Këto workshop-e kanë krijuar një mundësi për të forcuar lidhjet ndërmjet qytetarëve dhe administratës vendore dhe për të siguruar që politikat dhe projektet për energjinë dhe klimën janë të drejta dhe përfshirëse.

Në Bashkinë Berat, më 31 tetor 2024, u mbajt një workshop në Qendrën Multifunksionale Rinore, ku qytetarët dhe përfaqësues të sektorit privat dhe grupeve të interesit diskutuan mbi mundësitë për të kontribuar në zhvillimin e projekteve për energjinë dhe klimën në nivel vendor.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e transparencës në buxhetim dhe mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në monitorimin e zbatimit të planeve vendore, si dhe u diskutua për mënyrat e alokimit të burimeve financiare dhe nevojën për një angazhim më të madh të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Më 16 tetor 2024, në Bashkinë Roskovec, u zhvillua një workshop ku morën pjesë 16 pjesëmarës. Takimi kishte fokus të veçantë diskutimin mbi mënyrat për të përfshirë qytetarët në hartimin e buxhetit dhe në planifikimin e projekteve zhvillimore për vitin 2025, duke theksuar nevojën për transparencë dhe bashkëpunim të ngushtë mes qytetarëve dhe administratës vendore.

Në Bashkinë Divjakë, më 9 nëntor 2024 grupi i punës zhvilloi workshop për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes në buxhetim dhe monitorimin e planeve vendore për energjinë dhe klimën. Pjesëmarrësit diskutuan hapat dhe metodat që mund të përdoren për të siguruar një përfaqësim gjithëpërfshirës të grupeve të interesit, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe angazhimit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Në Bashkinë Gjirokastrë, më 24 tetor 2024, qytetarët dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme diskutuan për mundësitë e përfshirjes së qytetarëve në proceset e buxhetimit dhe monitorimin e planeve për energjinë dhe klimën. Pjesëmarrësit theksuan se një bashkëpunim i ngushtë mes qytetarëve dhe institucioneve do të mundësonte zhvillim të qëndrueshëm dhe përfshirës, si dhe mundësi për të rritur ndikimin e qytetarëve në politikat e nivelit vendor.

Në Korçë, më 15 tetor 2024, qytetarët dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme morën pjesë në një workshop, ku u diskutuan rëndësitë e transparencës dhe angazhimit të qytetarëve në proceset e buxhetimit dhe monitorimin e planeve të energjisë dhe klimës. Pjesëmarrësit ofruan sugjerime për mënyra më efikase për të përdorur fondet dhe për të siguruar një zbatim të plotë të planeve të zhvillimit.

Në Përmet, qytetarët morën pjesë në një workshop ku 15 persona diskutuan mënyrat se si mund të kontribuojnë në procesin e buxhetimit dhe si mund të sigurohet një buxhet i drejtë dhe i ekuilibruar për të gjithë qytetarët. Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu mekanizmat që bashkia përdor për të mbledhur mendimet e qytetarëve dhe për të siguruar që proceset e vendimmarrjes janë sa më transparente.

Në Shkodër, në shtator, më 16 pjesëmarës u zhvillua një workshop ku qytetarët diskutuan për përfshirjen e qytetarëve në zbatimin e Planit Vendor të Veprimit për Energjinë dhe Klimën. Pjesëmarrësit diskutuan për efikasitetin energjetik, përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe për ndotjen e ajrit, duke kërkuar që të rritet transparenca dhe përgjegjshmëria në përdorimin e fondeve për këto projekte.

4.2.4 Intervista me Bashkitë

Kordinatorët vendorë realizuan një sërë intervistash në bashkitë e Korçës, Beratit, Shkodrës, Divjakës, Përmetit, Gjirokastrës dhe Roskovecit, për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë që hasin punonjësit e administratës vendore në lidhje me menaxhimin e buxhetit dhe planifikimin e territorit. Qëllimi kryesor i këtyre intervistave ishte të mblidhnin informacion të detajuar nga punonjës të sektorëve të planifikimit të buxhetit dhe planifikimit të territorit, të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit të territorit dhe menaxhimin e burimeve financiare për këto projekte. Këto takime ndihmuan në identifikimin e nevojave për trajnim, mbështetje teknike dhe mundësitë për përmirësim në këto fusha kyçe.

Gjatë intervistave, u evidentuan disa sfida të përbashkëta që përballen bashkitë në menaxhimin e zhvillimit lokal dhe në zbatimin e planeve të planifikimit të territorit. Koordinimi i pamjaftueshëm ndërmjet njësive të administratës vendore doli si një nga vështirësitë kryesore, duke krijuar një hendek të dukshëm në lidhjen dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet departamenteve të ndryshme. Po ashtu, u theksua edhe mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore për të realizuar projektet e planifikuara, duke e bërë të vështirë realizimin e planeve dhe efektivitetin e zbatimit të strategjive të zhvillimit të territorit.

Për më tepër, punonjësit e këtyre bashkive shpesh shprehën nevojën për forcimin e kapaciteteve dhe mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit të planeve të zhvillimit, duke përfshirë nevojën për shfrytëzimin e mundësive të trajnimeve të avancuara dhe mbështetje teknike që mund të mundësojnë një menaxhim më të mirë të burimeve dhe të zbatimit të projekteve. Kjo është e nevojshme për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të harmonizuar të territoreve, që respekton jo vetëm nevojat e komunitetit lokal, por gjithashtu objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përmes këtyre intervistave, u ofrua mundësia për të krijuar një kuptim më të thellë të realiteteve të përditshme me të cilat përballen punonjësit e administratës vendore dhe për të kuptuar më mirë se si mund të përmirësohen proceset e zhvillimit dhe menaxhimit të territorit. Gjithashtu, intervistat i dhanë mundësi për identifikimin e mënyrave më të mira për të adresuar nevojat dhe sfidat e përbashkëta, duke avancuar në mënyrë të qëndrueshme proceset e zhvillimit lokal dhe duke përmirësuar menaxhimin e planeve të territorit në nivel vendor. Kjo ka rëndësi të madhe për të arritur një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm të bashkive dhe për të siguruar një të ardhme më të mirë për qytetarët.

Kordinatorët lokalë gjithashtu shprehën vështirësitë e hasura gjatë realizimit të intervistave, duke e konsideruar një sfidë të madhe dhe problematike sigurimin e takimeve me punonjësit e bashkive. Ata pohuan se vetëm përmes njohjeve të tyre personale dhe karrierës profesionale arritën të siguronin këto takime dhe të realizonin intervistat.

5 GJETJET KRYESORE

Përmbledhja e gjetjeve tregon se, pavarësisht përparimeve të arritura në disa bashki, sfidat kryesore mbeten në sigurimin e burimeve financiare dhe teknike, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e qytetarëve dhe OSHC-ve në proceset buxhetore dhe të zbatimit të PVVEEK. Në veçanti, nevojitet përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të siguruar një buxhetim më transparent dhe gjithëpërfshirës në të gjitha bashkitë e përfshira në projektin BAT.

Bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura nga 33 bashki, përfshirë intervistat me përfaqësues lokalë, përgjigjet nga kërkesat për informacion dhe workshop-et e organizuara, janë identifikuar gjetjet e mëposhtme:

Gjetjet janë të strukturuar sipas sfidave, praktikave pozitive dhe rolit të OSHC-ve dhe konsultimeve publike

5.1 Sfida Kryesore në Hartimin dhe Zbatimin e PVVEEK dhe Procesit Buxhetor

Mungesa e burimeve financiare dhe teknike: Një pjesë e madhe e bashkive raportuan se nuk kanë fonde të mjaftueshme për hartimin dhe zbatimin e PVVEEK. Për shembull, Bashkia Përmet theksoi se mungesa e fondeve ka penguar realizimin e masave të planifikuara për efikasitetin energjetik dhe klimën.

Stafet teknike të bashkive, veçanërisht në bashkitë më të vogla si Divjaka dhe Roskoveci, kanë ekspertizë të kufizuar për të zbatuar politikat e kërkuara nga Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë.

Pjesëmarrja e kufizuar e qytetarëve dhe OSHC-ve: Në disa bashki, si Roskoveci, konsultimet publike u raportuan si formale, me pjesëmarrje të kufizuar për shkak të mungesës së njoftimit të mjaftueshëm dhe kanaleve efektive të komunikimit me qytetarët.

Koordinimi i dobët ndërmjet institucioneve: Përfaqësuesit nga bashkia Gjirokastrë dhe Shkodër raportuan mungesë të qartësisë në udhëzimet e dhëna nga Agjencia Kombëtare për Eficiencën e Energjisë dhe Ministria e Financave për hartimin dhe raportimin e PVVEEK.

Ndërgjegjësimi i ulët i qytetarëve: Shumë qytetarë dhe grupe të interesit, siç raportuan bashkitë Përmet dhe Divjakë, nuk janë të informuar mbi të drejtat dhe mundësitë për t'u përfshirë në proceset buxhetore dhe politikat për energjinë dhe klimën.

5.2 Praktikë Pozitive dhe Rastet e Suksesit

Në disa bashki të Shqipërisë, përfshirja e qytetarëve dhe OSHC-ve ka treguar rezultate të dukshme. Në bashkitë Korçë dhe Berat, qytetarët janë përfshirë në procesin e konsultimeve publike, duke

marrë pjesë në takime të strukturuar dhe duke përdorur platforma online për të ndarë mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi prioritetet buxhetore. Kjo qasje ka mundësuar një pjesëmarrje më të gjerë dhe ka krijuar mundësi që qytetarët të jenë më të informuar dhe të kontribuojnë në proceset vendimmarrëse lokale.

Një tjetër hap përpara është bërë nga bashkitë Korçë dhe Shkodra në zbatimin e masave energjetike. Këto bashki kanë avancuar në përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe ndriçimit publik, duke zëvendësuar ndriçimin e vjetër me teknologji më efikase dhe duke rritur përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Këto hapa kanë kontribuar në uljen e shpenzimeve të energjisë dhe në përmirësimin e mjedisit, duke mbështetur realizimin e objektivave të PVVEEK.

Një tjetër element i rëndësishëm janë workshop-et dhe aktivitetet ndërgjegjëse të organizuara në kuadër të projektit BAT, i cili ka lehtësuar përfshirjen e qytetarëve në shtatë bashki, përfshirë Përmetin dhe Divjakën. Aktivitetet ndërgjegjëse, të cilat përfshijnë takime dhe sesione trajnimi për qytetarët dhe grupe të ndryshme shoqërore, kanë pasur një ndikim të madh në rritjen e kuptimit të qytetarëve për rëndësinë e përfshirjes aktive në proceset vendimmarrëse dhe për politikat që lidhen me energjinë dhe klimën. Përfaqësuesit lokalë dhe qytetarët kanë vlerësuar këto aktivitete si shumë të dobishme, pasi ato kanë ndihmuar në krijimin e një ndërgjegjësimi të madh rreth çështjeve të energjisë dhe ndryshimeve klimatike. Ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e lidhjeve mes OSHC-ve dhe qytetarëve dhe ka krijuar një hapësirë për një bashkëpunim më të ngushtë në nivel lokal.

5.3 Roli i OSHC-ve dhe Konsultimeve Publike

OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetje të procesit buxhetor dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Ato janë aktive në organizimin e dëgjësive publike, ku mundësojnë një dialog të hapur ndërmjet bashkive dhe qytetarëve, siç është raportuar nga bashkitë Berati dhe Divjaka. Ky angazhim siguron që qytetarët të kenë mundësi të shprehin mendimet e tyre dhe të ndikojnë në prioritetet buxhetore dhe politikat lokale.

Në disa raste, konsultimet publike kanë ofruar mundësi për identifikimin e prioritetëve të investimeve publike. Për shembull, në bashkitë Korçë dhe Përmet, qytetarët kanë sugjeruar projekte dhe investime që janë përfshirë më pas në planet buxhetore të bashkive. Ky proces i konsultimeve ka kontribuar në krijimin e një lidhjeje më të ngushtë midis qytetarëve dhe administratës vendore, duke siguruar që investimet publike të jenë më afër nevojave dhe interesave të komunitetit.

Megjithatë, OSHC-të, veçanërisht ato që operojnë në zona rurale, kanë hasur disa sfida. Një nga problemet kryesore është mungesa e burimeve financiare, që ka kufizuar mundësitë e tyre për të vazhduar aktivitetet mbështetëse. Kjo është e evidente në bashkitë Roskovec dhe Divjakë, ku mungesa e fondeve ka reduktuar ndikimin e OSHC-ve në procesin buxhetor dhe ka penguar realizimin e projekteve të rëndësishme.

Një tjetër sfidë e madhe është moskthimi i përgjigjeve nga administratat e bashkive. Kjo ka krijuar vështirësi në komunikimin dhe bashkëpunimin mes OSHC-ve dhe strukturave të administratës vendore. Për më tepër, takimet që janë organizuar me përpjekje të mëdha nga OSHC-të shpesh janë realizuar me shumë mund dhe pa angazhim të mjaftueshëm nga ana e punonjësve të administratës vendore. Ky mungesë angazhimi ka penguar rrjedhën e proceseve të planifikimit dhe ka shkaktuar vonesa dhe paqartësi në zbatimin e aktiviteteve mbështetëse, duke e bërë më të vështirë realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

6 REKOMANDIMET

Bazuar në gjetjet kryesore të raportit dhe analizën e situatës aktuale, rekomandimet synojnë të adresojnë sfidat kryesore dhe të përmirësojnë transparencën, gjithëpërfshirjen dhe zbatimin efektiv të Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK). Rekomandimet ndahen në dy kategori: për bashkitë dhe për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC).

6.1 Për Bashkitë: Masat për Përmirësimin e Transparencës dhe Gjithëpërfshirjes

1. **Përmirësimi i proceseve të konsultimit publik.** Një nga masat kyçe për përmirësimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në bashki është përmirësimi i proceseve të konsultimit publik. Ky proces duhet të organizohet në mënyrë më të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë dëgjesa publike që sigurojnë pjesëmarrjen aktive të të gjitha grupeve të interesit. Për ta arritur këtë, është e nevojshme të realizohen fushata informuese të përhapura përmes kanaleve tradicionale dhe digjitale. Po ashtu, duhet vendosur mekanizma të rregullt për mbledhjen dhe reflektimin e komenteve të qytetarëve në proceset buxhetore dhe në zbatimin e Planeve të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK).
2. **Rritja e transparencës për dokumentet dhe proceset vendimmarrëse.** Një tjetër hap i rëndësishëm është rritja e transparencës për dokumentet dhe proceset vendimmarrëse. Bashkitë duhet të publikojnë në kohë reale dokumentet e PVVEEK, planet buxhetore dhe raportet e zbatimit në faqet zyrtare dhe në regjistrin elektronik. Kjo do të mundësojë një informacion të vazhdueshëm dhe të lehtë për qytetarët dhe grupet e interesit. Për këtë qëllim, është e nevojshme të krijohet një program transparence që të përfshijë të gjitha fazat e procesit buxhetor, nga planifikimi deri te raportimi i rezultateve.
3. **Zhvillimi i kapaciteteve teknike të stafit të bashkive.** Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është zhvillimi i kapaciteteve teknike të stafit të bashkive. Për të realizuar masat për efikasitetin energjetik dhe klimën, është e domosdoshme trajnimi i menaxherëve të energjisë dhe stafit të njësive teknike. Kjo do të mundësojë një implementim dhe monitorim të suksesshëm të masave për eficiencën e energjisë dhe ndryshimet klimatike. Po ashtu, duhet të krijohen udhëzues dhe mjete të standardizuara për hartimin e PVVEEK, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë.
4. **Koordinimi më i mirë ndërmjet institucioneve lokale dhe qendrore.** Për të përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin, është e nevojshme një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet

institucioneve lokale dhe qendrore. Ky bashkëpunim duhet të realizohet me Agjencinë Kombëtare për Efiçencën e Energjisë dhe Ministrinë e Financave, me qëllim që të sigurohen udhëzime të qarta dhe mbështetje teknike për bashkitë. Po ashtu, duhet krijuar platforma ndërinstytucionale për ndarjen e praktikave më të mira dhe shkëmbimin e informacionit mbi zbatimin e PVVEEK.

5. **Mbështetje financiare për projektet e PVVEEK.** Mbështetja financiare për projektet e PVVEEK është thelbësore për një implementim të suksesshëm. Kjo mund të sigurohet përmes fondeve shtesë nga qeveria qendrore dhe donatorët ndërkombëtarë, të cilat do të mundësojnë hartimin dhe zbatimin e projekteve që lidhen me efiçencën energjetike dhe klimën. Gjithashtu, është e rëndësishme të krijohen grante të dedikuara për projekte që përfshijnë qytetarët dhe grupet e marginalizuara në proceset vendimmarrëse, duke e bërë kështu këtë proces më të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

6.2 Për OSHC-të: Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Rritja e Ndikimit

1. **Fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe organizative të OSHC-ve.** Një nga masat kryesore për rritjen e ndikimit të OSHC-ve është fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe organizative të këtyre organizatave. Ky proces përfshin organizimin e programeve trajnimi për OSHC-të, me fokus në monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike, si dhe buxhetimin gjithëpërfshirës dhe masat për energjinë dhe klimën. Po ashtu, është e nevojshme të mbështeten me burime teknike që do t'i ndihmojnë ata të ndjekin dhe analizojnë progresin e zbatimit të Planeve të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe Klimën (PVVEEK), duke mundësuar një vlerësim të vazhdueshëm dhe të saktë të rezultateve.
2. **Promovimi i rolit të OSHC-ve si ndërmjetës midis qytetarëve dhe bashkive.** Një tjetër hap i rëndësishëm është promovimi i rolit të OSHC-ve si ndërmjetës midis qytetarëve dhe bashkive. Kjo mund të arrihet duke forcuar kapacitetet e këtyre organizatave për të organizuar fushata ndërgjegjësuere mbi rëndësinë e përfshirjes qytetare në proceset buxhetore dhe vendimmarrëse. Gjithashtu, duhet ndërtuar mekanizma që i lejojnë OSHC-të të raportojnë rregullisht mbi transparencën dhe llogaridhënien e bashkive, duke siguruar një kontroll të pavarur dhe të rregullt mbi veprimet e administratës vendore.
3. **Sigurimi i mbështetjes financiare për OSHC-të.** Një nga sfidat më të mëdha për OSHC-të është sigurimi i mbështetjes financiare. Për këtë qëllim, duhet krijuar skema mbështetjeje financiare nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, me fokus në ato OSHC që operojnë në zona rurale ose me burime të kufizuara. Po ashtu, OSHC-të duhet të inkurajohen të bashkëpunojnë me donatorë dhe bashki për të zbatuar projekte të përbashkëta që promovojnë transparencën dhe gjithëpërfshirjen, duke krijuar mundësi për rritjen e ndikimit të tyre në nivel lokal.
4. **Përmirësimi i angazhimit të OSHC-ve në nivel strategjik.** Përmirësimi i angazhimit të OSHC-ve në nivel strategjik është një tjetër hap i domosdoshëm. OSHC-të duhet të sigurohen që të jenë të përfaqësuar në forume vendimmarrëse dhe konsultative, në mënyrë që të rrisin ndikimin e tyre në hartimin e politikave. Kjo mund të realizohet përmes krijimit të rrjeteve të

bashkëpunimit midis organizatave, të cilat mund të ndajnë praktikat më të mira dhe të rrisin ndikimin kolektiv të tyre në zhvillimin e politikave publike

5. **Përmirësimi i ndërgjegjësimit qytetar për rolin e OSHC-ve.** Për më tepër, duhet të përmirësohet ndërgjegjësimi qytetar për rolin e OSHC-ve në mbrojtjen e interesave të tyre në proceset publike. Aktivitetet ndërgjegjëse mund të përfshijnë organizimin e ngjarjeve që informojnë qytetarët mbi rëndësinë e OSHC-ve dhe përfshirjen e tyre aktive në proceset vendimmarrëse. Përdorimi i kanaleve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mediat sociale dhe platformat online, mund të ndihmojë në informimin e komunitetit mbi të drejtat e tij dhe mundësitë për të pasur ndikim në vendimmarrje.

7 ANEKSE

1. Kërkesë për informacion drejtuar bashkive

Tiranë më 29 Korrik 2024	
Nga:	Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri
Lënda:	Kërkesë për informacion
I nderuar z. Kryetar,	
Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri (INLSH) ka nisur në Maj 2024 zbatimin e një projekti që synon të fuqizojë dhe mbështesë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) në monitorimin, vlerësimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin buxhetor dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për energjinë dhe klimën.	
Ky projekt po zbatohet në kuadër të nismës “Kapacitetet e Mbikëqyrjes Qytetare për Llogaridhënie dhe Transparencën Buxhetore: BAT-Shoqëria Civile”, i cili zbatohet nga IDM në bashkëpunim me Qendrën CRPM dhe Faktoje, i financuar nga Bashkimi Evropian (EuropeAid/174080/DD/ACT/).	
Në kuadër të projektit do të përgatitet një raport monitorimi për të 61 bashkitë në nivel kombëtar për të vlerësuar nëse Planet Vendore të Veprimit për Eficencën e Energjisë dhe Klimës janë hartuar në secilën bashki dhe janë marrë masa respektive të parashikuara në buxhetin vjetor të bashkisë ose nëse bashkitë kanë parashikuar në buxhetin vjetor të bashkisë fonde për zbatimin e masave të ndryshme të Eficencës së Energjisë.	
Raporti do të fokusohet në mënyrë specifike në analizimin e buxhetimit me pjesëmarrje që zhvillohet në secilën bashki për të parë nëse masat e parashikuara në buxhetin vjetor për eficientësinë e energjisë janë hartuar në konsultim me publikun dhe grupet e ndryshme të interesit.	
Kjo kërkesë për informacion i dërgohet në mënyrë zyrtare të gjitha bashkive në Republikën e Shqipërisë. Informacioni që kërkojnë është i detajuar sipas pyetjeve më poshtë.	
1. A ka hartuar Bashkia juaj Planin Vendor të Veprimit për Eficencën e Energjisë dhe Klimën?	
a) Nëse PO, A keni parashikuar fonde në buxhetin vjetor të bashkisë për zbatimin e Planit Vendor të Veprimit për Eficencën e Energjisë dhe Klimën? Sa janë këto fonde dhe cilat aktivitete specifike mbulojnë?	
b) Si vlerësoni zbatimin deri tani të këtij plani? A keni ndonjë statistikë ose raport që mund të ndani me ne?	
c) A është përfshirë komuniteti lokal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në procesin e hartimit ose rishikimit të Planit Vendor të Veprimit për Eficencën e Energjisë dhe Klimën. Nëse Po, në çfarë mënyrash janë përfshirë?	
d) A është përfshirë komuniteti lokal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në procesin e buxhetimit të Planit Vendor të Veprimit për Eficencën e Energjisë dhe Klimën. Nëse Po, në çfarë mënyrash janë përfshirë?	
2. Nëse bashkia nuk e ka hartuar akoma Planin Vendor të Veprimit për Eficencën e Energjisë dhe Klimën.	

a) A keni marrë ndonjë masë tjetër alternative për të zbatuar masat e parashikuara në legjislacionin shqiptar për eficientë e energjisë?
b) Si vlerësoni efektivitetin e masave të zbatuara deri tani për eficientë e energjisë dhe klimës në bashkinë tuaj?
c) A është përfshirë komuniteti lokal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në procesin e buxhetimit të këtyre masave për Eficientë e Energjisë dhe Klimën. Nëse Po, në çfarë mënyrash janë përfshirë?
3. Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje
a) A zhvillohet procesi i buxhetimit me pjesëmarrje në bashkinë tuaj?
b) Si përfshihet komuniteti në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje?
c) Cfarë sugjerimesh keni marrë në lidhje me masat e eficientës së energjisë gjatë procesit të buxhetimit me pjesëmarrje?
d) Si e realizoni komunikimin me grupet e interesit/komunitetin për t'a ftuar të marrë pjesë në procesin e konsultimeve për buxhetin?
4. Zbatimi i masave të eficientës së energjisë
a) A keni ndonjë program ose nismë për të edukuar dhe informuar komunitetin mbi eficientë e energjisë dhe ndryshimet klimatike?
b) Nëse po, cilat janë këto programe dhe çfarë aktivitete përfshijnë?
c) Çfarë rekomandimesh keni për përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut dhe OSHC-ve në planifikimin dhe zbatimin e masave të eficientës së energjisë dhe klimës?
5. Cilat janë sfidat kryesore që has bashkia juaj në zbatimin e masave të eficientës së energjisë dhe klimës?
a) Si keni planifikuar t'i adresoni këto sfida?
Mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, INLSH do të vlerësonte përgjigjet tua në lidhje me informacionin e kërkuar.
Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj.

2. Intervista e strukturuar

Pyetje mbi Procesin e Buxhetimit
1. Si është strukturuar dhe organizuar procesi i diskutimit të buxhetimit për vitin 2025 në bashki?
2. Cilat janë fazat kryesore të planifikimit buxhetor dhe kush është përfshirë në to?
3. Si merren parasysh prioritetet dhe nevojat e qytetarëve gjatë hartimit të buxhetit?
Pyetje mbi Pjesëmarrjen e Qytetarëve
4. Si është siguruar pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e buxhetimit deri më tani?
5. A ekziston një mekanizëm formal për mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga qytetarët?
6. Cilat grupe qytetarësh janë përfshirë deri tani në proces dhe si janë identifikuar ata?
Pyetje mbi Transparencën dhe Informacionin për dokumentat
7. Si siguroheni që dokumentacioni i planifikimit buxhetor të jetë i aksesueshëm për

qytetarët?
8. A janë dokumentet buxhetore të publikuara në mënyrë që të jenë lehtësisht të kuptueshme për publikun?
9. Çfarë lloj informacioni shtesë mund të jetë i disponueshëm për qytetarët që duan të ndjekin nga afër procesin e buxhetimit?
Pyetje mbi vendimmarrjen dhe vendosjen e prioriteteve
10. Cilat janë prioritetet kryesore të bashkisë për vitin 2025 dhe si janë përcaktuar ato?
11. Si planifikon bashkia të adresojë çështjet që janë ngritur nga qytetarët në të kaluarën?
12. A ka hapësirë për ndryshime në buxhet pas marrjes së komenteve nga qytetarët?
Pyetje mbi monitorimin
13. Si monitorohet zbatimi i buxhetit dhe si raportohen rezultatet?
14. A ka bashkia një sistem për të vlerësuar efektivitetin e projekteve dhe shpenzimeve të përfshira në buxhet?
15. Si sigurohet bashkia që qytetarët të jenë të informuar dhe të përfshirë në monitorimin e zbatimit të buxhetit?
Pyetje për Çështjet e Eficencës së Energjisë
16. Në dijeninë tuaj çfarë masash specifike për eficientë e energjisë janë planifikuar të përfshihen në buxhetin e vitit të ardhshëm?
17. Mendoni që Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, specifikisht për të përmirësuar eficientë e energjisë në ndërtesat publike dhe infrastrukturë po reflektohet në projekt - buxhetin vjetor të 2025?

3. Minutat e takimit të workshop-it sipas bashkisë

Bashkia Berat – Më 31 tetor 2024.

Bashkia Roskovec – Më 16 tetor 2024.

Bashkia Divjakë – Më 9 nëntor 2024.

Bashkia Gjirokastër – Më 24 tetor 2024.

Bashkia Korçë – Më 15 tetor 2024.

Bashkia Përmet – Më 24 shtator 2024.

Bashkia Shkodër – Më 29 shtator 2024.

4. Intervistat e përcjella nga korrespondentët